

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Fushë Kosova – Raporti komunal

Nëntor 2009

## Fushë Kosova në shifra

<b>Popullsia</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>38,063</b>
	Shqiptarë	80.9%
	Ashkalinj	9.9%
	Serb	7.3%
	Të tjerë	2.2%
<b>Gjeografia</b>	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	<b>100</b>
	Numri i fshatrave	<b>17</b>
<b>Shkollimi</b>	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	<b>14.28%</b>
	Fillore/e mesme e papërfunduar	<b>29.63%</b>
	E mesme	<b>47.35%</b>
	Shkollë e lartë	<b>7.14%</b>
	Universitet	<b>1.59%</b>
	Nr. i nxënësve	<b>7,504</b>
	Nr. i mësimdhënësve	<b>353</b>
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	<b>3</b>
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	<b>14</b>
	Nr. i çerdheve	<b>2</b>
<b>Shëndetësia</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	<b>1</b>
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	<b>10</b>
	Nr. i mjekëve	<b>24</b>
<b>Papunësia</b>	Gjithsej	<b>49.10%</b>
	Meshkuj	<b>40.87%</b>
	Femra	<b>67.43%</b>
<b>Të punësuar</b>	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	<b>23,218</b>
	Të punësuar në sektorin publik komunal	<b>704</b>
<b>Buxheti 2009</b>	Gjithsej (Euro)	<b>3,968,382</b>
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	<b>650,000</b>
	Të hyrat tjera (Euro)	<b>3,318,382</b>
<b>Shpenzimet e realizuara (2008)<sup>1</sup></b>	Gjithsej (Euro)	<b>3,801,721 (93%)</b>
	Shpenzimet kapitale (Euro)	<b>1,202,586 (84%)</b>
	Shpenzimet tjera (Euro)	<b>2,599,135 (97%)</b>
<b>Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007</b>	LDK	<b>33.17%</b>
	PDK	<b>27.21%</b>
	AKR	<b>20.88%</b>
	LDD	<b>5.64%</b>
	AAK	<b>3.50%</b>
	PDAK	<b>2.51%</b>
	ORA	<b>2.48%</b>
	Tjera	<b>4.61%</b>
<b>Kryetarët e Komunës 2000-2009</b>	2000-2002: Skender Zogaj (LDK) 2002-2007: Skender Zogaj (LDK) 2007-2009: Burim Berisha (LDK)	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Fushë Kosovën

Fushë Kosova, e krijuar si komunë në vitin 1988, është zhvilluar shumë sidomos në 10 vitet e fundit pas përfundimit të luftës. Kohëve të fundit, një pjesë e madhe e Fushë Kosovës është shndërruar në zonë industriale, ku janë përqendruar shumë biznese, jo vetëm nga Prishtina, por edhe nga anë të tjera të Kosovës. Kjo ka ndikuar që Fushë Kosova të kthehet në një qendër biznesi shumë të rëndësishme për tërë Kosovën. Fushë Kosova është një ndër komunat e Kosovës me popullsi etnikisht të përzier, ku shqiptarët, ashkalinjtë dhe serbët jetojnë së bashku pa probleme të mëdha.

## Problemet aktuale

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët e komunës së Fushë Kosovës janë:

- Mungesa e ujit të pijshëm;
- Gjendja urbanistike;
- Rruga magjistrale;
- Ambienti dhe kualiteti i ajrit;
- Hapësira e pamjaftueshme e çerdheve;

**Mungesa e ujit të pijshëm.** Komuna e Fushë Kosovës furnizohet me ujë nga Liqeni i Batllavës, ashtu siç furnizohet edhe një pjesë e Prishtinës dhe komuna e Obiliqit. Furnizimi menaxhohet nga ujësjellësi rajonal "Prishtina". Mirëpo, Fushë Kosova ka probleme të mëdha me furnizim me ujë të pijes. Gjatë sezonit të verës, qytetarët e kësaj komune përballen me reduktime shumë të gjata, në rastet më ekstreme, ata nuk kanë ujë fare në një ditë 24 orëshe. As në sezonin e dimrit nuk është gjendja më e mirë. Pasi që komuna e Fushë Kosovës është njëra ndër komunat me rritjen më të madhe dhe më të shpejtë të popullsisë, burimet aktuale të ujit nuk mjaftojnë për të furnizuar këtë komunë me ujë të pijshëm. Uji nga liqeni i Batllavës konsiderohet nga qytetarët e kësaj komune se nuk ka ujë shumë cilësor dhe se nuk preferohet për pije, andaj ata blejnë bidonë uji për pije, edhe kur vie uji nga ujësjellësi, por të cilin e përdorin për larje. Fushë Kosova ka edhe burime të tjera të ujit të pijes, mirëpo ato burime konsiderohet si jo shumë cilësore për pije. Po ashtu, një tjetër problem që i shtohet problemit paraprak është edhe faturimi i parregullt që i nënshtrohet qytetarëve të Fushë Kosovës. Banorët, edhe pse me mungesë të ujit, detyrohen të paguajnë një shumë të hollash në emër të disa shpenzimeve të detyrueshme për mbarëvajtjen e sistemit të gypave ku kalon uji. Ky problem bashkë me problemin e cekur më sipër, kërkojnë nga ana e qytetarëve një vëmendje të posaçme në zgjidhjen e menjëhershme të kësaj çështje tepër jetike.

**Gjendja urbanistike.** Siç u përmend edhe më sipër, komuna e Fushë Kosovës është komuna me rritjen më të madhe të popullsisë që nga pas lufta. Krahas kësaj edhe ndërtimet janë rritur në mënyrë të ndjeshme duke shkatuar probleme të shumta. Komuna e Fushë Kosovës nuk ka mundur që të zë hapin e ndërtimeve dhe të vërë kontroll mbi to, duke i detyruar ndërtuesit që të kërkojnë leje në komunë. Komuna edhe pse e ka të miratuar planin urbanistik të qytezës, ai nuk është i zbatueshëm fare në praktikë, ngase gjendja në terren ndryshon shumë nga plani i hartuar dhe i miratuar urbanistik, kurse komuna është treguar e paaftë që të përshtas gjendjen

aktuale me planin urbanistik, qoftë edhe duke rrënuar objektet pa leje. Për më tepër, ka disa objekte që nuk janë penguar fare gjatë ndërtimit të tyre nga autoritetet komunale të Fushë Kosovës. I tillë është rasti me ndërtesën e cila ndodhet afër rrethit në qendër të qytetit (ndërtesa nuk ka ndonjë emërtim të veçantë që të mund të identifikohet më lehtë, mirëpo gjenden në anën e djathtë të rrethit, posa të merret kthesa për në rrugën e aeroportit). Kjo ndërtesë ka dëmtuar planin e qytetit, pasi që ndodhet shumë afër rrethit dhe vështirëson lëvizjen e lirë të automjeteve dhe këmbësorëve. Po ashtu edhe ndërtesa në anën e djathtë të rrugës duke shkuar kah objekti i KK, një ndërtesë me tulla të kuqe, është ndërtim që bie ndesh me planin urbanistik të qytetit. Në rrugën “Dardania” për shkak të ndërtimeve në proces e sipër, qytetarët frikohen se do tu rrezikohet jeta për shkak se ndërtimet nuk janë të siguruara për të mos rrezikuar jetën e qytetarëve që ecin poshtë tyre. Po ashtu gjatë ndërtimeve në këtë rrugë, mjetet transportuese e kanë dëmtuar shumë rrugën për shkak të ngarkesës së rëndë. Në brendi të qytetit, ndodhen dy kompani të cilat kanë instaluar bombola të gazit, ku vitin e kaluar ka humbur jetën një person nga shpërthimi i tyre. Qytetarët janë të frikësuar për sigurinë e tyre, ngase në rast të ndonjë aksidenti, bombolat mund të shkatërrojnë shumë shtëpi për rreth. Me fjalë të tjera, në Komunën e Fushë Kosovës, komuna nuk i ka nën kontrollë ndërtimet dhe do të mbetet sfidë për katër vitet e ardhshme të qeverisjes që udhëheqësia komunale të zgjidh edhe këtë problem.

**Rruga magjistrale.** Përderisa magjistranja Prishtinë-Aeroport (Sllatinë) konsiderohet nga Qeveria e Kosovës si një nga projektet më madhore të saj, qytetarët e komunës së Fushë Kosovës janë në hall me këtë rrugë. Për shkak të ndërtimeve të shumta për skaj rrugë, pa marë leje në komunë, banorët që kanë shtëpitë, bizneset dhe banesat pranë rrugës magjistrale janë duke u përballur me problemin që rruga u është afuar deri tek dyert e hyrjes. Në shumë pika të rrugës, dera kryesore e banesave dhe lokaleve, por edhe e garazheve të automjeteve, ndodhet vetëm disa metra larg rrugës. Kjo rrugë ka ndarë qytetin në dysh. Përderisa shumë zëra të kësaj komune kanë kërkuar që rruga të gjej një aks tjetër më në periferi të qytetit, Qeveria e Kosovës sërish e ka ndërtuar këtë autostradë mu në mes të qytetit. Për shkak se shtëpitë janë shumë afër në të dy anët e rrugës, nuk ka mbetur hapësirë për ndërtimin e mbi kalimeve dhe nën kalimeve. Qytetarët për skaj kësaj rrugë shprehen të jenë ankuar tek kryetari i komunës, mirëpo përgjigjja e tij ka qenë se nuk ka fuqi për ta zgjidhur këtë problem. Sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Vetëqeverisje lokale, komunat kanë kompetencë që të menaxhojnë me territorin e tyre dhe rrugët lokale. Mirëpo Fushë Kosova ka një problem më kompleks. Rrugën kryesore në mes qytetit nuk ka kompetencë ta menaxhojë vetë, pasi që ajo njëkohësisht është edhe kompetencë e nivelit qendror pasi llogaritet si rrugë regjionale. Edhe rruga e ndërtuar në vitin 2008 nga Prishtina e deri tek rrethi në Fushë Kosovë ka të njëjta probleme. Që nga ndërtimi i kësaj rrugë kanë ndodhur shumë ndeshje dhe lëndime, sidomos në pjesën afër supermarketit “INTEREX”. Nuk ka askund vendkalime për këmbësorë. Pjesët e gjelbëruara që ndodhen në rripin e ngushët në mes të autostradës, nuk mirëmbahen dhe shkelen nga kalimtarët të cilët kalojnë rrugën ku u bie më së afërmi.

**Ambienti dhe kualiteti i ajrit.** Për shkak të afërsisë që ka kjo komunë me termocentralet në Obiliq, kualiteti i ajrit është shumë i rënduar. Kësaj i shtohet edhe ndotja që vije nga automjetet që kalojnë për çdo ditë në qendër të qytetit, mungesa e hapësirave gjelbëruese dhe kundërmimi dhe papastërtia e lumit Sitnica. Të gjitha këto ndikojnë që shëndeti i popullatës të vihet në rrezik. Edhe pse komuna nuk ka kompetenca që të zgjidh problemin e ndotjes nga termoelektranat, komuna mund të

angazhohet që të zgjerojë hapësirat gjelbëruese, të mbjell drunjt që do të filtronin ajrin e ndotur, të pastroj lumin Sitnica dhe të largojë mbeturinat.

**Hapësira e pamjaftueshme e çerdheve.** Krijta e madhe e popullsisë ka shkatuar edhe një problem: mungesën e hapësirës për çerdhe. Sipas informatave, personat që janë vendosur me banim në Fushë Kosovë në këto vitet e fundit, janë persona që janë me punësim në Prishtinë apo në vendet përreth. Andaj ka kërkesa të mëdha që fëmijët e tyre t'i dërgojnë në çerdhe. Fushë Kosova ka vetëm një çerdhe publike, e cila nuk i plotëson nevojat e qytetarëve. Tani së fundmi është hapur edhe një çerdhe multietnike, me qëllim që prindërit shqiptarë dhe serbë t'i dërgojnë fëmijët në këtë çerdhe, mirëpo deri më tani kjo nuk është funksionale. Prindërit edhe më tuje vazhdojnë t'i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhet në Prishtinë, e që në anën tjetër edhe Prishtina ka problem me hapësirën e çerdheve. Në Fushë Kosovë nuk është vërejtur ndonjë iniciativë private për hapjen e çerdheve, kurse komuna nuk ka treguar vullnet në këtë drejtim. Në rast se komuna dëshiron të hap një çerdhe të re publike, duhet të mendoj edhe për një problem: Komuna e Fushë Kosovës nuk ka nën menaxhim të saj pronë publike komunale. Dhe për çdo ndërtim të ri, qoftë objekt arsimor apo shëndetësor, komuna duhet të mendoj se si t'ia bëj me mungesën e hapësirës, pasi që blerja e tokës për ndërtim do të kushtoj më shumë se sa vetë ndërtimi i objektit.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Më 17 nëntor 2007 Burim Berisha fitoi 3.361 vota apo 35.5%, kurse në zgjedhjet e balotazhit tri javë më vonë ai fitoi 4.145 vota apo 55.9%. Kryetari aktual i Fushë Kosovës nuk pati premtuar shumë në zgjedhjet e kaluara lokale. Megjithatë, si duket kryetari i Fushë Kosovës i ka përmbushur një pjesë të mirë të premtimeve, edhe pse disa prej tyre mbesin të realizohen ose të vazhdojnë të realizohen në tërësi.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Përmbushja e premtimeve
Pastrimi i të gjithë deponive të egra. Vendosja e kontejnerëve në të gjitha fshatrat, ku së paku me projektin e deponive të egra do të kushtojë 200.000 euro.	Ashtu siç është premtuar, janë vendosur kontejnerë në të gjitha lokalitetet e komunës së Fushë Kosovës, mirëpo jo në numër të mjaftueshëm sa për të mbuluar mjaftueshëm një lokalitet të caktuar. Numri jo i mjaftueshëm i kontejnerëve dhe mungesa e mirëmbajtjes së tyre nga kompania përkatëse ka bërë që këta kontejner të stërbushen me mbeturina dhe vendi i kontejnerit është shndërruar në deponi bërlloku. Këtë vit janë blerë 100 kontejner për tërë komunën në vlerë prej 70.000 eurove.
Në afat prej dy viteve të asfaltohet 23 km rrugë në fshatra dhe një pjesë të rrugës në qytetin e Fushë Kosovës, projekt që do të kushtojë 1 milion e 600 mijë euro; 300.000€ të shpenzohen në mirëmbajtje të ndryshme, ambient, infrastrukturë, etj.	Premtimi është përmbushur pjesërisht. Janë asfaltuar gjithsejtë pesë rrugë në vlerë të përgjithshme prej 202.000 euro
Vendosja e nxejve qendrore nëpër shkolla,	Janë realizuar projektet për sistemimin e

projekt me vlerë 140.000€	nxemjeve qendrore në shkollat e këtyre fshatrave: Lismir, Bardhë i Vogël dhe Pomozetin. Nga 10 shkollat në gjuhën shqipe, vetëm shkolla në Graboc nuk ka nxemje.
Nxehje qendrore në shëndetësi, 60.000€	Në 2008, QKMF e Fushë Kosovës ka arritur që në bashkëpunim me KFOR-in të futet në objektin e shëndetësisë i cili ka qenë i bllokuar nga serbët. Në këtë objekt është e instaluar nxehja qendrore.
Në gjurmime arkeologjike, 70.000€	Gjurmimet në Kalanë e Halilaçit kanë vazhduar edhe në këto dy vitet e fundit
Në fshatin Vragoli të vendoset kontejner dhe të përfundohet gropa septike;	Gjatë 2008 në fshatin Vragoli janë vendosur kontejnerët dhe është asfaltuar rruga, kurse në 2009 parashihet edhe ndërtimi i një ure që lidh këtë fshat me Kuzminin.

## Zgjedhjet lokale në Fushë Kosovë

Komuna e Fushë Kosovës që nga zgjedhjet e pra lokale pas luftës është udhëhequr nga LDK-ja. Në zgjedhjet e para dhe të dyta lokale të vitit 2000 dhe 2002 LDK-ja pati një fitore të bindshme, duke siguruar shumicë të mjaftueshme në Kuvendin Komunal për të kaluar vendime dhe propozime, pa qenë e varur prej këshilltarëve të partive të tjera. Ndërsa në zgjedhjet e fundit lokale në vitin 2007, ndarja e LDK-së dhe humbja në nivelin qendror ndikoi edhe në rezultatin e zgjedhjeve në Fushë Kosovë. LDK-ja pati gati dyfish më pak vota në vitin 2007, në krahasim me vitin 2002, mirëpo megjithatë arriti që të sigurojë më së shumti ulëse në Kuvend Komunal.

Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës përbëhet prej 21 anëtarëve. Më së shumti këshilltarë në KK ka LDK, gjithsejtë shtatë. Mirëpo, edhe pse nuk ekziston koalicion formal me ndonjë subjekt tjetër politik, LDK arrin që të kalojë të gjitha propozimet dhe të marrë vendime ngase anëtarët e partive të tjera i mbështesin propozimet e kryetarit dhe të LDK-së. LDK mbështetjen e merr nga një këshilltar i ORA-s, një i AAK-së, një i komunitetit ashkali dhe një i LDD-së.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Fushë Kosovës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	1724	4	2481	5	2516	6
LDK	5513	13	5375	12	3067	7
AAK	1077	3	205	1	324	1
LDD	-	-	-	-	521	1
AKR	-	-	-	-	1930	4
PDAK	379	1	401	1	232	1
ORA	-	-	-	-	229	1
IQFK	-	-	592	1	-	-
Povratak	-	-	632	1	-	-

Numri i votuesve që kanë dalur në të 3 palë zgjedhjet lokale në Fushë Kosovë ka qenë përafërsisht i njëjtë, në vitin 2000 dhe 2002 kanë dalur në zgjedhje rreth 10,000 votues, ndërsa në vitin 2007 ky numër ka rënë në rreth 9,000. Mirëpo, numri i votuesve me të drejtë vote në Fushë Kosovë ka pasur oscilime të mëdha në mes të 4 palë zgjedhjeve, duke i përfshirë edhe zgjedhjet lokale të këtij viti, vitit 2009. Numri i votuesve me të drejtë vote është dyfishuar nga viti 2000 në vitin 2002, nga rreth 12,000 në rreth 24,000, ndërsa në vitin 2007 ky numër pati rënë në rreth 20,000, kurse sivjet përsëri është rritur në mbi 26,000. Kjo bën që edhe pse numri absolut i atyre që kanë dalë në zgjedhje ka qenë i njëjtë, pjesëmarrja në përqindje ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga viti 2000 në vitin 2002 dhe nuk lëviz fare nga viti 2002 në vitin 2007.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Fushë Kosovë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	12420	24081	20427	26143
Pjesëmarrja në votime	10184	10876	9245	-
Përqindja e daljes në votime	82.0%	45.16%	45.2%	-

## Buxheti i Komunës

Buxheti i komunës së Fushë Kosovës ka përjetuar ngritje dhe rënie prej viti në vit. Në vitet 2004 dhe 2005 ka pasur një ngritje të ndjeshme të vazhdueshme, ndërsa në vitet në vijim, 2006 dhe 2007 ka pasur një rënie prej rreth 500,000 Euro për të dy vitet. Megjithatë, duke filluar prej vitit 2008 buxheti i komunës së Fushë Kosovës përsëri ka filluar trendin e rritjes, duke u rritur prej 2,9 milion në vitin 2007 në 3,9 milion në vitin 2009. Gjithashtu vërehet se edhe shpenzimet kapitale kanë pësuar rënie së bashku me buxhetin e përgjithshëm, në vitet 2006-2007, ndërsa rrogat dhe mëditjet kanë mbajtur një trend më stabil gjatë këtyre viteve. Gjithashtu e vlen të theksohet se në vitin 2006, kur buxheti i përgjithshëm i kësaj komune ka pësuar një rënie prej rreth 400,000 Euro, si dhe shpenzimet kapitale kanë rënë për rreth 500,000 Euro, shpenzimet për mallra dhe shërbime bashkë me subvencionet dhe transferet janë rritur së bashku për rreth 85,000 Euro.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	2,110,364	314,149	162,000	39,098	1,342,771	-	3,968,382
2008	1,834,047	349,054	112,070	39,097	875,571	-	3,209,839
2007	1,774,871	338,623	112,223	30,000	708,571	-	2,964,288
2006	1,767,606	410,593	111,649	47,500	750,183	-	3,087,531
2005	1,768,442	366,499	118,100	6,785	1,232,973	-	3,492,799
2004	1,734,348	397,823	-	-	1,108,902	20,446	3,261,519
2003	1,212,492	651,009	-	-	602,158	69,202	2,534,861



Buxheti i komunës së Fushë Kosovës për vitin 2009 është planifikuar të jetë gati 4 milion Euro, prej të cilave rreth 650,000 Euro janë të hyra vetanake të komunës, që është rreth 16% e buxhetit të përgjithshëm. Edhe pse në përshtypjen e parë kjo shifër mund të duket e lartë, megjithatë e vlen të theksohet se të hyrat vetanake të komunës së Fushë Kosovës kanë pësuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2006 kur të hyrat vetanake kanë qenë gati 1 milion euro.

Në bazë të planifikimit të buxhetit të kësaj komune në vitet në vijim, pritet që ky buxhet të shënojë rritje të konsiderueshme prej rreth 600,000 Euro në vitin 2010 dhe ngritje të lehtë në vitet tjera në vijim.

## Investimet kapitale

Buxheti për shpenzime kapitale në Fushë Kosovë ka pësuar ngritje dhe rënie nga viti në vit, me ç'rast vlerat më të ulta për shpenzime kapitale kanë qenë gjatë viteve 2006-2007, ku kjo komunë ka pasur në dispozicion vetëm rreth 700,000 Euro në vit për investime kapitale. Buxheti për investime kapitale në vitin 2009 është përmirësuar dhe ka arritur vlerën prej rreth 1,3 milion Euro dhe planifikohet që të vazhdojë ngritjen deri në 1,6 milion Euro në vitin 2012.

Tab.5.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Fushë Kosovë 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	4,658,972	4,743,828	4,906,784
Të hyrat vetanake në €	952,782	983,029	1,011,386
Investimet kapitale në €	1,500,000	1,550,000	1,600,000

Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Fushë Kosovës do të ketë në dispozicion **4,650,000 €** për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Fushë Kosovës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth **6.2 milion €** për investime kapitale.

Gjatë vitit 2008 të gjitha investimet kapitale në komunën e Fushë Kosovës kanë qenë investime në asfaltim të rrugëve nëpër fshatrat e kësaj komune. Ndërsa në vitin 2009 projektet më të rëndësishme kapitale kanë qenë për ndërtimin e një fushe të sportit, ndërtimin e një kanalizimi dhe vazhdimin e asfaltimit të rrugëve.

Tab.6.: Investimet kapitale në Fushë Kosovë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Bardh i Madhë	€79,888
2008	Asfaltimi i rrugës në Henc	€80,000
2008	Asfaltimi i rrugës Lismir-Nakarad	€63,797
2008	Asfaltimi i rrugës në Harilaq	€23,000
2009	Ndërtimi i fushës së sportit në fshatin Grabovc	€60,000
2009	Ndërtimi i kanalizimit në Nakarad	€30,000
2009	Asfaltimi i rrugës në Miradi të epërme	€15,417



## Administrata komunale

Numri i të punësuarve në sektorin publik në komunën e Fushë Kosovës, në administratë, arsim dhe shëndetësi, që nga viti 2003 ka qenë rreth 700 duke lëvizur me ndryshime të vogla poshtë dhe lartë nga viti në vit.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Fushë Kosovës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	722 ▲
2008	711 ▲
2007	700
2006	730
2005	736
2004	757 ▲
2003	735 ■

Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46 administrata komunale e Fushe Kosovës duhet te këtë më së shumti 109 punonjës. Në vitin 2006 kanë qenë 166 punëtorë në administratën komunale të Fushë Kosovës, ndërsa në vitin 2008 kjo komunë ka arritur ta sjellë këtë numër në nivelin e paraparë sipas vendimit të lartpërmendur të Qeverisë. Megjithatë, në vitin 2009 numri i punëtorëve të administratës komunale përsëri është rritur për 30 punëtorë.

## Komuna e Fushë Kosovës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, kuvendi komunal duhet të mbajë të paktën 10 mbledhje, KK i Fushë Kosovës ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, kuvendi komunal i kësaj komune ka mbajtur 6 mbledhje, duke përbushur kështu normën e paraparë me nenin 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Komiteti për politikë dhe financa gjatë 2008 është takuar vetëm 6 herë, apo karar herë më pak se sa Kuvendi Komunal. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës dhe ky komitet cakton rendin e ditës për KK. Edhe pjesën e parë të 2009 KPF nuk është takuar rregullisht. Gjatë kësaj periudhe ka mbajtur vetëm 2 mbledhje.

Sa i përket bashkëpunimit me qytetarët, komuna e Fushë Kosovës ka mbajtur 3 tubime publike gjatë vitit 2008, kurse brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, ajo ka mbajtur një. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare, nuk ka ndonjë të dhënë nëse komuna e Fushë Kosovës ka pranuar ndonjë kërkesë. Qytetarët për këto dy vite kanë dorëzuar dy peticione në komunë.

Ueb faqja e komunës së Fushë Kosovës është e pajisur me informacione të konsiderueshme, aq sa një qytetari të Fushë Kosovës do t'i nevojiteshin rreth aktiveteteve të komunës dhe më gjerë. Në pikëpamje të kategorive, informacioneve, dokumenteve, të dhënave dhe niveleve të informatave tjera që janë publikuar në këtë

ueb faqe, del që ueb faqja ka përmbajtje të mjaftueshme rreth organizimit komunal dhe bazës ligjore, mirëpo mungojnë informacione në pikëpamje të shërbimeve komunale, si dhe pasqyrimin të projekteve kapitale në komunën e Fushë Kosovës.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës (<http://www.fushekosova-komuna.org>)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>2</sup>
Ballina	4
Organizimi komunal	4
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	2.75
Projektet komunale	1.5
Lajme& lajmërim	2
Harta e faqes	1
Kontakt	3
Gjuhët	1
Fusha për kërkim	4
Tjera informacione shtesë	1
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	2.35
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	22

## Gjendja në arsim

Në komunën e Fushë Kosovës zhvillojnë mësimet 7,532 nxënës. Ekzistojnë 7 shkolla fillore në gjuhën shqipe dhe dy shkolla fillore në gjuhën serbe, një shkollë e mesme në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbe.

Ka shkolla në klasat e të cilave zhvillojnë mësimin 50 - 60 nxënës në një klasë dhe shkollat në qytet zhvillojnë mësimet në tri ndërrime. Pastërtia dhe rendi në këto shkolla janë në gjendje të rëndë. Për këtë ka pasur edhe ankesa të shumta të prindërve për përmirësimin e pastërtisë nëpër shkolla. MASHT ka premtuar ndërtimin e një shkolle të mesme, mirëpo problemi më i madh është mungesa e hapësirës publike ku të ndërtohet kjo shkollë, dhe në mungesë të kësaj hapësire DAK në Fushë Kosovë është e obliguar që të ngushtoj hapësirën e shkollës "Selmon Riza".

Në 2008 janë bërë renovime të shkollën "Selmon Riza", në shkollën "Mihal Grameno" dhe në shkollën në Bardh të Madh. Të gjitha investimet për renovime kanë qenë participim i komunës me MASHT, mirëpo shuma më e madhe afro 80% është dhënë nga MASHT. Renovimi i shkollës "Mihal Grameno" ka filluar pas fillimit të vitit shkollor (tetor 2008), me ç'rast janë dërguar nxënësit në pushim deri në renovim e shkollës. Opozita akuzon se një renovim i tillë është dashur të bëhet gjatë sezonit të verës e jo pas fillimit të procesit mësimor dhe nxënësit të humbin mësimin.

<sup>2</sup> Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Përveç shkollës “Laura Scotti” në Grabocit, të gjitha shkollat tjera kanë nxehje qendrore.

Ka pasur kritika të shumta në mbarëvajtjen e konkursit dhe përzgjedhjes së personelit arsimor. Opozita akuzon se përzgjedhje është bërë në baza partiake, drejtorët e shkollave janë të politizuar, nuk janë hapur konkurse për lëndët e muzikës dhe artit për shkak se drejtorët u kanë ndarë lëndë plotësuese kolektivit të tyre.

Nxënësit serb zhvillojnë mësimet ndaras nga nxënësit shqiptarë. Objektivin e shkollës së mesme në qytet para ditë e shfrytëzojnë nxënësit serb (80 nxënës), kurse pas dite nxënësit shqiptarë në klasave të ulëta, ngase nuk është lejuar zhvillimi i mësimin të nxënësve të klasave më të larta.

Komuna e Fushë Kosovës ka vetëm një çerdhe të vetme dhe kjo çerdhe nuk i plotëson nevojat e kësaj komune në rritje. Drejtori i Arsimit shprehet se komuna nuk ka mundësi dhe hapësirë që të ndërtoj një çerdhe të re publike, mirëpo shpreson se një iniciativë e tillë do të merret nga ndonjë person privat. Sipas PDK-së, afër shkollës “Mihal Grameno” ekziston shkolla e ndërtuar nga një donacion ndërkombëtar, mirëpo komuna ka dështuar që ta fusë në funksion.

Në testin kombëtar të maturës kalueshmëria e nxënësve ka qenë vetëm **28.7%**. Kjo shifër është zhgënjyese edhe për vetë udhëheqësit e arsimit të komunës.

## Gjendja në shëndetësi

Fushë Kosova ka një qendër kryesore të mjekësisë familjare dhe kjo qendër ka një hapësirë të mirë për sigurimin e shërbimeve shëndetësore, i cili i plotëson të gjitha nevojat e një Qendre të Mjekësisë Familjare. Përveç kësaj, kjo komunë ka edhe 10 qendra të mjekësisë familjare dhe punkte shëndetësore, ndërsa numri i mjekëve të angazhuar në këtë sektor në këtë komunë është 24.

## Shoqëria civile

Edhe përkundër faktit që ekzistojnë një mori problemesh me të cilat ballafaqohet komuna e Fushë Kosovës çdo ditë dhe duke pasë për bazë indinjatën rreth zhvillimeve dhe qasjes se autoriteteve komunale në raport me zgjedhjen e këtyre problemeve, mungon qasja kritike dhe avokimi ndaj problemeve të përgjithshme që kryesisht ishte dashur të vinte nga shoqëria civile. Megjithëse janë disa organizata që veprojnë në komunë, edhe pse me kapacitet vërtetë të kufizuar për të luajtur rolin e tyre siç janë: OJQ “Akti”, pastaj organizata “Hendikos” që merret me çështje të personave invalidor si dhe KMDLNJ që është active në rrafshin e mbrojtës së të drejtave të njeriut. OJQ “Akti” edhe pse si mision të vetin primar ka luftimin e dukurive negative që paraqiten në komunë si dhe lobimin apo avokimin për ndryshime të mirëfillta në jetët e qytetarëve, kjo organizatë shihet nga shumë qytetarë si vegël e organeve komunale dhe është gati inaktive sa i përket mbrojtjes së interesit të qytetarëve në raport me vendimet e kuvendit komunal. Vlen të përmendet edhe roli shumë domethënës i KMDLNJ-së ku si rezultat është arritur një harmoni kuptimplote në mes grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në këtë komunë.

Komuna e Fushë Kosovës veçohet si njëra ndër komunat ku raporti në mes grupeve etnike është në nivel të kënaqshëm.

## Mediat lokale

Mediat po ashtu kanë një rol jo të mjaftueshëm në raportimin e ngjarjeve të ndryshme që ndodhin në qytetin e Fushë-Kosovës në përgjithësi. Vetëm një radio lokale vepron në këtë komunë dhe ajo është "Radio K" e cila emiton programe kryesisht të karakterit artistik. Pra nuk është e angazhuar në programe tjera siç janë raportimi i debateve që mbahen në kuvendin komunal apo organizimi i debateve që do të kishin si qëllim shtjellimin e problemeve të ndryshme me të cilat komuna ballafaqohet çdo ditë.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Fushë Kosovës

Nga 1 janari 2008 deri më 31 dhjetor 2008, në Komunën e Fushë Kosovës kanë ndodhur 1,288 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 54 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Fushë Kosovë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	344
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	83
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	8
Vjedhje e pyjeve	0
Incidente lidhur me pronën	41
Vjedhje	305
Abuzime seksuale	7
Shkaktim të dëmtimeve trupore	56
Kërcënime	53
Mashtrime	21
Vrasje	0
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlllogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimore të tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj, Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës ka miratuar edhe Rregulloren komunale për tatim në

pronë, sipas së cilës është caktuar vlera e pronës në treg, norma tatimore dhe zonat e komunës.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Fushë Kosovës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	<b>Norma tatimore</b>				
	0.10%	0.10%	0.22%	0.15%	0.10%
<b>Zona</b>	<b>Vlera e tregut për metër katror</b>				
<b>I</b>	450 €	290 €	650 €	150 €	100 €
<b>II</b>	420 €	250 €	600 €	150 €	100 €
<b>III</b>	390 €	220 €	550 €	150 €	100 €
<b>IV</b>	-	200 €	450 €	150 €	100 €

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Në Komunën e Fushë Kosovës janë të regjistruara rreth 1,000 biznese. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale e Fushë Kosovës. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumatat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	450-810 €
Kompanitë e sigurimit	540 €
Ndërmarrjet shërbyese - tregtare (shitja e derivateve deri në dy dhe mbi dy doza)	693 - 1350 €
Kompanitë ndërtimore	450-1980 €
Kafenetë	133-183 €
Hotelet	656 €
Motelet	336 €
Restorantet	313 €
Supermarketet-Hipermarketet	432 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	342 €
Agjensionet turistike	270-450 €
Barnatoret farmaceutike	225 €
Auto-mekanikët	43-225 €
Gurëthyesit	-
Depo të materialit ndërtimor	615 €
Auto-shkollat	260 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.